

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë, lidhur me sa vijon:

A. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë

I.Për apartament me sip. 76 m², në Tiranë, në rrugën “*****”, Tiranë, për çmimin 60,800 euro, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimet e krijimit si vijon:

- a) të ardhura nga paga e subjektit si prokuror dhe magjistrat, nga paga e bashkëshortes si gjyqtare dhe magjistrate dhe juriste pranë Bashkisë Tiranë;
- b) kontratë huamarrje (verbale) prej 10,000 euro me vjehrrën, znj. N. T.;
- c) kontratë huamarrje (verbale) prej 5,000 euro me babanë I.Ç.;
- ç) kontratë kredie me “Alpha Bank” sh. a. në vlerën prej 3,000,000 lekësh.

Komisioni ka kryer analizë të secilit prej burimeve të deklaruara për blerjen e pasurisë apartament me çmimin 60,800 euro, në Tiranë, si vijon:

- i) shuma 18,000 euro, paguar më 9.9.2008, me burim kursimet nga pagat e bashkëshortëve, likuiditeteve të tërhequra nga bankat dhe përdorimi i likuiditeteve *cash*;
- ii) shuma 19,000 euro, paguar më 12.12.2008, me burim dy huat e marra nga prindërit e secilit prej bashkëshortëve në vlerat 10,000 euro dhe 5,000 euro e 4,000 euro, nga pagat gjatë vitit 2008;
- iii) shuma 20,000 euro, paguar më 10.3.2009, me burim kredinë e marrë në “Alpha Bank”;
- iv) shuma 3,643 euro, paguar më 24.4.2010, nga të ardhurat.

1. Lidhur me pagesën e këstit të parë në vlerën 18,000 euro, paguar më 9.9.2008, me burim kursimet nga pagat e bashkëshortëve, likuiditeteve të tërhequra nga bankat dhe përdorimi i likuiditeteve *cash*.

1.1. Burimi i kursimeve nga pagat e bashkëshortëve, likuiditete të tërhequra nga bankat dhe likuiditete *cash* për të paguar shumën 18,000 euro, analizohet nga momenti i krijimit të tyre, bazuar në të dhënat e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ pas verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së tyre, në raport me të dhënat e deklaratave periodike të pasurisë.

1.2. Në deklaratat e interesave private para fillimit të detyrës, është deklaruar si vijon:

Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

(i) autoveturë tip “*****”, në shumën 500,000 lekë, me burim krijimi dhuratë nga prindërit; (ii) llogari rrjedhëse në “Tirana Bank”, në shumën 140,000 lekë, me burim krijimi kursime nga paga në pozicionet e mëparshme, si student në Shkollën e Magjistraturës, dieta etj.; (iii) shumën 200,000 lekë gjendje *cash*, me burim kursimet e pagës dhe dhuratë nga prindërit.

Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, znj. A. A., në datën 3.11.2006, deklaroi: (i) llogari bankare depozitë me afat 1-mujor në shumën 1,200 USD në “Tirana Bank”, me pjesë 100%, me burimi krijimi dhuratë e bërë nga babai; (ii) llogari bankare rrjedhëse në shumën 300,000 lekë në “Tirana Bank”, me pjesë 100%, me burimi krijimi dhuratë nga nëna; (iii) shumën 500,000 lekë *cash*, nga paga në pozicionin e mëparshëm dhe gjatë kohës si studente në Shkollën e Magjistraturës.

1.3. Referuar të dhënave nga “Tirana Bank”¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, ka depozituar në llogarinë e tij në datën 17.10.2006, shumën 1.500.000 lekë (pas emërimit të tij në detyrë në datën 4.10.2006) dhe ka kryer lëvizjet e vlerave monetare në këtë llogari, si vijon: (i) tërheqje në *cash*, në shumën 700,000 lekë, në datën 18.10.2006; (ii) tërheqje në *cash*, në shumën 100,000 lekë në datën 20.10.2006; (iii) transferim në llogari të znj. A.A. në shumën 300,000 lekë, në datën 26.10.2006; (iv) tërheqje në *cash* në shumën 260.000 lekë në datën 26.10.2006.

1.4. Për sa më sipër, vlerat monetare, gjendje *cash*, në shumën 200,000 lekë, gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në “Tirana Bank”, në shumën 140,000 lekë, si dhe gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Tirana Bank” të personit të lidhur në shumën 300,000 lekë, deklaruar në deklaratat e interesave private para fillimit të detyrës referuar të dhënave bankare², kanë burim krijimi veprimet financiare pas depozitimit nga subjekti të shumës 1,500,000 lekë, në datën 17.10.2006.

1.5. Analiza mbi mundësinë financiare të subjektit për krijimin e shumës prej 1,500,000 lekësh, depozituar *cash* në llogarinë e tij në lekë në “Tirana Bank” në datën 17.10.2006, referuar dokumentacionit disponuar për periudhën 4.10.2006 – 17.10.2006, mbi gjendjet e likuiditeteve deklaruar dhe evidentuar në datën 4.10.2006, të ardhurat e transferuara për periudhën, shpenzimet e jetesës dhe vlerat monetare në datën 17.10.2006, do të rezultonte si vijon:

Analizë financiare për periudhën 4.10.2006 – 17.10.2006	
Përshkrimi	
Pasuri	1 288 370
<i>shtesa/pakësime likuiditete</i>	1 288 370
Detyrime	0
Detyrim	0
Pasuri neto	1 288 370
Të ardhura dokumentuar	32 266
Të ardhura nga punësimi i subjektit, për periudhën në “Raiffeisen Bank”	29 870
Të ardhura nga interesa bankare në “Tirana Bank”	2 396
Shpenzime	3 902
Shpenzime jetese sipas standardit të ILDKPKI-së	3 902
Mundësia për Kursime	-1 260 006

1.6. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme të deklaruara shumën prej 1,500,000 lekësh të depozituara *cash* në datën 17.10.2006, në “Tirana Bank”, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 1,260,006 lekë.

1.7. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme gjendjen *cash* në shumën 200,000 lekë, vlerat monetare në llogarinë rrjedhëse në “Tirana Bank” në shumën 140,000 lekë, si dhe vlerat monetare në llogarinë rrjedhëse të personit të lidhur në “Tirana Bank”, në shumën 300,000 lekë, pasi kanë burim depozitimin e shumës 1,500,000 lekë në datën 17.10.2006, në “Tirana Bank”, analizuar më sipër.

1.8. Vlerat monetare më sipër, nuk mund të përfshihen në analizën financiare për pagesën e kësteve të apartamentit në vitin 2008, pasi nuk plotësojnë parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Kthim përgjigjeje me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018.

² Kthim përgjigjeje me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018.

1.9. Në DPV-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) pakësim të llogarisë rrjedhëse në “Tirana Bank” për shumën 57,000 lekë; dhe (ii) shtuar gjendje e kursimeve cash në shumën 100,000 lekë.

1.10. Duke iu referuar të dhënave nga “Tirana Bank” rezulton që subjekti i rivlerësimit në datën 4.10.2006, ka pasur gjendje në llogari në këtë bankë shumën prej 3,305 lekësh dhe në datën 31.12.2006, shumën prej 83,517 lekë, çka tregon se vlerat monetare në këtë bankë të nivelit të dytë nuk janë zvogëluar, por janë shtuar me shumën prej 80,212 lekësh.

1.11. Ndërsa në lidhje me gjendjet e llogarive të znj. A. A., llogaria rrjedhëse në lekë në “Tirana Bank” nuk është pakësuar me shumën 50,000 lekë, por është shtuar me shumën 185,801 lekë.

1.12. Për sa më sipër, ka mospërputhje mes pakësimeve të likuiditeteve në bankë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në DPV-në e vitit 2006.

1.13. Neni D, pikat 2 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, udhëzimi i ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit jo vetëm për deklarimin e “pasurisë” së tij, por edhe të “burimit” në momentin e krijimit të saj.

1.14. Subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar³ si burim për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit në rrugën “*****”, Tiranë: (i) dhuratë nga nëna e bashkëshortes; (ii) dhuratë nga babai i bashkëshortes në shumën prej 1.200 USD në depozitë të bashkëshortes në “Tirana Bank”; si dhe (iii) dhuratë nga babai i subjektit, pjesë e shumës cash, prej 200,000 lekësh.

1.15. Vlerat monetare në depozitën me afat në “Tirana Bank” (1,200 USD), dhurata e bërë nga babai i bashkëshortes dhe dhurata e bërë nga babai i subjektit, pjesë e shumës cash prej 200,000 lekësh, nuk mund të merren në analizë si burim për pagesën e kësteve të apartamentit në vitin 2008, pasi nuk kanë pasur si burim të ardhura nga pagat dhe shpërblimet.

1.16. Në përfundim, subjekti dhe personi i lidhur kanë pamjaftueshmëri të burimit financiare, të ardhurave, si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rrugën “*****”, Tiranë, si dhe ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarim për kontrollin e pasurisë sipas germave “a” dhe “b”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Lidhur me pagesën e kështit të dytë në vlerën 19,000 euro, më 12.12.2008, me burim dy huat e marra nga prindërit e secilit prej bashkëshortëve në vlerat 10,000 euro, 5,000 euro dhe 4,000 euro, nga pagat e bashkëshortëve gjatë vitit 2008.

a) Huamarrja prej 5,000 euro nga z. I. Ç., deklaruar si burim krijimi

2.1. Huaja e marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit në shumën 5,000 euro, konfirmohet me deklaratën noteriale, datë 23.1.2017, ku shtetasi I. Ç. deklaroi se në vitin 2008 i ka dhënë hua shumën prej 5,000 euro, pa afat dhe pa interes, djalit të tij Arens Çela për blerjen e banesës me shtetasen A. A. dhe se kjo shumë i është kthyer totalisht.

2.2. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndodhur para një marrëdhënieje të konfirmuar të huas, iu kërkua subjektit të rivlerësimit dokumentacioni ligjor provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.

2.3. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) autoveturë tip “***”, në shumën 500,000 lekë, dhuratë nga prindërit; dhe (ii) shumën 200,000 lekë gjendje cash, me burim kursimet dhe dhuratë nga prindërit.

³ Deklaruar në deklarimin për herë të parë në datën 3.11.2006 nga znj. A.A..

2.4. Në DPV-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi huamarrje me babanë I.Ç., në shumën 5,000 euro.

2.5. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi huamarrje me babanë I.Ç., në shumën 1,430,000 lekë, me qëllim shlyerjen e kredisë.

2.6. Analiza financiare e pasurive dhe shpenzimeve në raport me të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit, mbi mundësinë financiare të prindërve të subjektit për blerjen e automjetit në shumën 500,000 lekë dhuruar subjektit në vitin 2006, dhënien hua subjektit në shumën 5,000 euro në vitin 2008, si dhe dhënien hua subjektit në shumën 1,430,000 në vitin 2011 lekë, duhet të kryhej gjithëpërfshirëse për të arritur në një vlerësim sa më të drejtë mbi mundësinë e prindërve të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e dhuruara dhe dhëna hua subjektit.

2.7. Llogaritja duhet të kryhej gjithëpërfshirëse, referuar edhe faktit se dhënia e huas në shumën 5,000 euro në vitin 2008 është deklaruar e palikuiduar deri në datën 31.12.2011 nga subjekti, faktit se me kontratën e hipotekës, datë 22.1.2009, prindërit e subjektit vendosën barrë hipotekore, për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit, dy apartamente të ndodhura në qytetin e Lushnjës, si dhe përdorimit prej subjektit të njërit prej këtyre apartamenteve.

2.8. Lidhur me shumën 1,430,000 lekë, hua në vitin 2011 lekë, referuar të dhënave nga “Alpha Bank”, nga llogaria dyemërore P. Ç. dhe I. Ç., u transferuan në datën 30.11.2011, shumat 1,300,000 lekë dhe 144,000 lekë, në llogarinë e subjektit dhe bashkëshortes në këtë bankë.

2.8.1. Shumat e mësipërme në llogarinë e prindërve kanë ardhur si rezultat i maturimit të depozitave me afat me shuma të kaluara në këtë llogari në datën 30.7.2010, në vlerë 1,107,640 lekë dhe nga derdhja *cash* në datën 8.2.2011 nga z. I. Ç. e shumës prej 250,000 lekësh.

2.8.2. Nisur nga sa më sipër, mundësia financiare e prindërve të subjektit, për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e dhuruara dhe dhëna hua subjektit, duhej të analizohet mbi dokumentacionin e disponuar deri në datën 8.2.2011, konkretisht:

Analizë financiare për periudhën 1994 – 8.2.2011	
Përshkrimi	Vlera/lekë
Të ardhura <i>neto</i> të babait të subjektit për periudhën 1994 – 2004 ⁴	2.051.484
Të ardhura <i>neto</i> të babait të subjektit për vitin 2005, referuar “Raiffeisen Bank”	468.628
Të ardhura <i>neto</i> të babait të subjektit për periudhën 2006 – 2010 ⁵	2.899.388
Të ardhura <i>neto</i> të babait të subjektit për 1.1.2011– 8.02.2011, referuar “Raiffeisen Bank”	149.279
Të ardhura të nënës së subjektit për periudhën 1994 – 2005 ⁶	2.302.638
Të ardhura <i>neto</i> të nënës së subjektit për periudhën 2006 – prill 2007, referuar “Tirana Bank”	454.353
Të ardhura <i>neto</i> të nënës së subjektit për periudhën 2007 – 2010 ⁷	1.730.416
Të ardhura <i>neto</i> të nënës së subjektit për 1.1.2011 – 8.2.2011, referuar “Raiffeisen Bank”	73.918
Trashëgimi nëna	500.000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 1999	1.000.000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në datën 13.11.2006	1.800.000
Kredi e marrë në “Alpha Bank” me kontratë në datën 23.4.2007	1.217.800
Të ardhura të tjera (interesa)	50.460
Total të ardhura dhe të hyra financiare (1)	14.698.364

⁴ Referuar vërtetimeve për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare.

⁵ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 13.8.2018, të DRSh-së.

⁶ Referuar vërtetimeve për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare.

⁷ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 31.8.2018, të Qendrës Shëndetësore Nr. ***, Lushnjë.

Dhurim automjeti për subjektin në vlerën 500,000 lekë deklaruar në vitin 2006	500.000
Hua dhënë subjektit për blerje apartamenti në vitin 2008, shuma e deklaruar 5,000 euro	619.000
Vlera monetare në depozitë në “Alpha Bank”, shërbyer si burim për huan e dhënë subjektit për shlyerje përpara afatit të kredisë së marrë këtë bank për blerje apartamenti në vitin 2011	1.357.640
Pagesë për blerje pasuri ap. me sip. 77 m ² dhe sip.107 m ² , referuar kontratës së porosisë, datë 10.3.2006, me çmim 26,950 euro dhe 37,450 euro	7.909.286
Pagesë për blerje pasurie apartament me sip. 65 m ² , në Lushnjë me kontratën e datës 25.6.1997	1.150.000
Pagesë shlyerje kredie tek “Alpha Bank” (principal+interes) për periudhën	1.246.811
Gjendje në llogaritë bankare në datën 8.2.2011 (“Raiffeisen Bank” dhe “Alpha Bank”)	504.104
Shpenzime jetike deri më 31.12.1999 (në masën 66%) të të ardhurave familjare ⁸	986.695
Shpenzime jetike sipas INSTAT ⁹ nga viti 2000	3.597.724
Total shpenzime dhe të dala financiare (2)	17.871.260
Diferenca (1-2)	-3.172.896

2.9. Për sa më sipër, rezulton se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të dokumentuara nga burime të ligjshme të mjaftueshme për:

- blerjen e automjetit, dhuruar subjektit në vitin 2006, në shumën 500,000 lekë;
- dhënien hua subjektit, në shumën 5,000 euro, në vitin 2008;
- dhënien hua subjektit, në shumën 1,430,000 lekë, në vitin 2011;
- investimin në pasuri dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën.

2.10. Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e krijimit të shumës 5,000 euro, nga babai, dhënë hua subjektit dhe përdorur si burim krijimi për pasurisë apartament, në përputhje me paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.11. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e krijimit të shumës 500,000 lekë nga prindërit, për dhurimin e automjetit subjektit në vitin 2006, si dhe të shumës 1,430,000 lekë në vitin 2011, përdorur për shlyerje kredi, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

b) Huamarrja prej 10,000 euro nga znj. N.T. deklaruar si burim krijimi

2.12. Me deklaratën noteriale të datës 25.1.2017, shtetasja N. T. deklaroi se në vitin 2008 i ka dhënë hua shumën prej 10,000 euro, pa afat dhe pa interes, vajzës A. A. për ta ndihmuar për blerjen e banesës me bashkëshortin A. Ç. dhe se kjo shumë i është kthyer totalisht.

2.13. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndodhur para një marrëdhënieje të konfirmuar të huas, iu kërkua subjektit të rivlerësimit dokumentacioni ligjor provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënëses.

2.14. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se: “Nëna e bashkëshortes sime, znj. N. T., ka realizuar të ardhura në shumën prej 1,900,000 lekësh, si rezultat i shitjes së pasurisë së paluajtshme familjare, duke bashkëlidhur një kopje të kontratës noteriale nr. ****, datë 29.8.2006, për shitje pasurisë së paluajtshme”.

2.15. Referuar kontratës së shitblerjes të pasurisë së paluajtshme me rezervë të datës 29.8.2006, shtetasja N.A. (T.), nëna e bashkëshortes së subjektit, ka shitur një pasuri me sip. 20 m², në Lushnjë, kundrejt çmimit 400,000 lekë.

⁸ Referuar jurisprudencës së Kolegjit.

⁹ Nga viti 2000 – 10/2004 llogaritur për 4 persona; 11/2004 – 10/2008, për 3 persona; 11/ 2008 – 8.2.2011, për 2 persona.

2.16. Ndërsa pasurinë apartament me sip. 54 m² shtetasja N.A. (T.), nëna e bashkëshortes së subjektit, e ka pasur në bashkëpronësi me ish-bashkëshortin e saj dhe kjo pasuri rezulton se u shit prej tyre në çmimin 1,500,000 lekë.

2.17. Në referencë të nenin 199, paragrafi i dytë, i Kodit Civil, i cili parashikon: “Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta”, pjesa takuese e nënës së bashkëshortes së subjektit është 50% e kësaj banese, rrjedhimisht edhe vlera e të ardhurave të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, rezulton 50% për secilin bashkëpronar.

2.18. Shuma takuese e përfituar nga shtetasja N.A. (T.), nëna e bashkëshortes së subjektit, rezulton në vlerën 750,000 lekë(50% e të ardhurave përfituar nga shitja).

2.19. Deklarata e babait të bashkëshortes së subjektit (bërë gjatë pyetjes si dëshmitar gjatë hetimit administrativ), nuk mund të rrëzojë parashikimet e dokumentit ligjor kontratë shitje.

2.20. Neni 690 të Kodit Civil, përcakton se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj.

Kontrata e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbën provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose veprimet e kryera”.

2.21. Për sa nuk ekziston shkak ligjor, që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën noteriale të shitblerjes, analiza financiare duhej bërë duke marrë në konsideratë vetëm në vlerën 1,150,000 lekë, e cila ishte shumë e provuar me dokumentacion ligjor provues, si e përfituar nga shtetasja N.A. (T.), nëna e bashkëshortes së subjektit.

2.22. Përfshirja e të ardhurave në vlerën 1,150,000 lekë do të sillte si rezultat konkluzionin se shtetasja N.A. (T.), nuk ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien hua subjektit në shumën 10,000 euro në vitin 2008.

2.23. Nga hetimi administrativ, referuar të dhënave bankare të administruara nga Komisioni, rezulton se për periudhën 2009 – 2013, nëna e bashkëshortes së subjektit, shtetasja N.A. (T.), ka shtuar vlera të konsiderueshme monetare në këto dy llogari depozitë.

Periudha Institucioni financiar/	2009	2010	2011	2012	2013
“ABI Bank” (Ilog dep/lekë)	509.143	881.190	901.056	921.188	938.427
“Tirana Bank” (Ilog. dep/euro)	7.000	24.606	33.051	35.613	36.052
“Raiffeisen Bank” (Ilog. dep/ekë)		924.196	924.196	797.362	814.819

2.24. Në referencë të dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, vërtetim nr. *** prot., datë 3.7.2019, të ISSh-së, rezulton se shtetasja N. T., trajtohet me pension invaliditeti me datë fillimi 28.12.2009, aktualisht të ardhurat totale mujore janë 15,534 lekë. Shumat e përfituara nga shitja e pasurive nga ana e huadhënëses, referuar depozitimeve të mësipërme, nuk provohen nëse janë përdorur për huan dhënë subjektit apo për krijimin e vlerave monetare në llogaritë e huadhënëses, pas dhënies së kësaj huaje.

2.25. Bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e krijimit nga znj. N.T. të shumës 10,000 euro dhënë hua subjektit, përdorur si burim krijimi për pasurisë apartament, në përputhje me paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3. Në lidhje me automjetin në përdorim nga subjekti i rivlerësimit

3.1 Me deklaratën noteriale, datë 16.10.2010, shtetasi D. A. (kunati i subjektit), i ka dhënë subjektit në përdorim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, automjetin tip “****”, me targa ***, deri në datën 15.10.2011.

3.2. Referuar të dhënave nga DSHPTRr-ja, ky automjet është blerë nga shtetasi D. A. (vëllai i bashkëshortes së subjektit), në datën 18.1.2010, kundrejt çmimit 900,000 lekë. Policat e sigurimit për këtë automjet janë prerë në emër të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2016. Referuar të dhënave të sistemit *TIMS* ky automjet nuk është përdorur asnjëherë nga shtetasi D. A..

3.3. Në këto rrethana, kjo marrëdhënie e huas, që parashikon pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, karakterizon kunatin e subjektit të rivlerësimit, si person tjetër të lidhur, për këtë pasuri dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

3.4 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor, për burimin e të ardhurave të z. D. A. (kunati i tij), për blerjen e automjetit “*****”, në shumën 900,000 lekë, në datën 18.1.2010. Nga hetimi administrativ rezultoi që ky shtetas nuk ka pasur të ardhura të dokumentuara, për të cilat janë shlyer detyrimet përkatëse tatimore¹⁰.

3.5 Referuar fakteve të poshtëshënuara:

- i) e ka përdorur këtë automjet, pa kundërshpërblim deri në vitin 2016;
- ii) nuk e ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore 2010 – 2016 këtë huapërdorje;
- iii) kjo pasuri në huapërdorje është blerë nga kunati i subjektit të rivlerësimit, i cili nuk provon me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti duhet të provonte, tej dyshimeve të arsyeshme, se nuk është përpjekur të fshehtë këtë pasuri.

4. Të dhëna të tjera nga hetimi administrativ

4.1 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar dhënien e huas në shumën 500,000 lekë për nënën e bashkëshortes, e cila nuk është deklaruar e kthyer në DPV-të për vitet 2015 dhe 2016.

4.2. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se me kontratën e sipërmarrjes, datë 27.8.2014, shtetasja N. T. (nëna e bashkëshortes së subjektit), ka porositur pranë shoqërisë “*****” sh.p.k., apartamentet me nr. **** dhe ****, me sip. 163.1 m² (të bashkuar në një apartament të vetëm), për çmim të përgjithshëm 114,170 euro.

4.3. Në këtë kontratë është përcaktuar se... *shuma prej 108,460 euro, do të paguhet me lidhjen e kësaj kontrate në datën 27.8.2014, ndërsa shuma prej 5,710 euro, do të paguhet me dorëzimin e hipotekë.*

4.4. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, shtetasja N. T.:

- i) ka derdhur *cash* në llogari rrjedhëse në euro në emër të saj në datën 27.8.2014, shumën 21,000 euro, me përshkrim të deklaruar “të ardhura nga kursimet”;
- ii) ka derdhur *cash* në llogari rrjedhëse në euro në emër të saj në datën 28.8.2014, shumën 48,000 euro, me përshkrim të deklaruar “tërheqje nga banka të tjera nga shitje pronash”;

¹⁰ Në përgjigje të pyetësorit të datës 11.2.2020, subjekti, në lidhje me të ardhura të përfituara nga kunati i tij, ndër të tjera, deklaroi se: “...në vite ka qenë i vetëpunësuar duke kryer punë të ndryshme ...duke punuar në mënyrë periodike dhe duke mos paguar sigurimet shoqërore ...”.

iii) ka përfituar transferuar nga z. I. Ç. në datën 28.8.2014, shumën 39,000 euro, me përshkrim “dhënie huaje për blerje apartamenti”;

iv) në datën 28.8.2014 ka transferuar për shoqërinë “*****” sh.p.k., shumën 108,000 euro me përshkrim “kryerje pagese 90% të blerjes së apartamentit sipas kontratës së datës 27.8.2014, nga N.T.”.

4.5. Në lidhje me huan e kaluar me transfertë nga babai i subjektit, z. I.Ç., për shtetasen N. T. në datën 28.8.2014, në shumën 39,000 euro, referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” në llogaritë rrjedhëse në emër të babait të subjektit, ka rezultuar si vijon:

-në datën 10.1.2012 është derdhur *cash* prej z. I. Ç., shuma 23,000 euro;

-në datën 12.10.2012 është depozituar shuma 1,000 euro, nga znj. A.A., me përshkrim “shlyerje huaje”;

-në datën 29.7.2013 është depozituar shuma 2,500 euro, nga subjekti i rivlerësimit pa përshkrim;

-në datën 31.10.2013 është depozituar shuma 2,000 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrimin “Arens Çela derdh për I.Ç.”;

-në datë 6.5.2014 është depozituar shuma 2,500 euro, nga subjekti i rivlerësimit me përshkrimin “Arens Çela derdh për I.Ç.”;

-në datën 25.7.2014 është depozituar shuma 1,500 euro, nga subjekti i rivlerësimit me përshkrimin “Arens Çela shlyerje detyrimi”.

4.6. Për sa më sipër, në llogarinë bankare të babait janë depozituar vlera monetare nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, të cilat kanë qenë pjesë e shumës prej 39,000 euro të dhëna hua nga shtetasi I.Ç. shtetases N. T. në datën 28.8.2014.

4.7. Referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm të babait të subjektit për dhënien e kësaj huaje, ka rezultuar se si burim janë përdorur të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 66.3 m², në Lushnjë.

4.8. Kjo pasuri është porositur nga shtetasi I.Ç., mbi bazën e kontratës së porosisë, datë 10.3.2006, kundrejt shumës 26,950 euro. Në datën 18.3.2006, nga babai i subjektit, z. I.Ç., është paguar për blerje apartamentesh në Lushnjë, shuma prej 35.000 USD.

4.9. Në datën 13.3.2006, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në “Tirana Bank”, shtetasja M.S. ka derdhur shumën prej 35,039 USD, shumë e cila është tërhequr nga znj. A. A., më 17.3.2006. Lidhur me këtë konstatim është pyetur subjekti, i cili, shpjegoi se: *“shtetasja shqiptaro-amerikane, znj. M. S., është tezja ime. Shuma e parave prej 35,039 USD është tërhequr prej bashkëshortes time për t’ia kaluar më pas mamasë time, znj. P. Ç.(P.), pasi ky ishte qëllimi i transaksionit dhe mamaja ime nuk kishte llogari bankare, në dollarë ”.*

4.10. Në vitin 2012, kjo pasuri i është shitur nga babai i subjektit shtetasit J.G.S. (djali i shtetases M. S., e cila kreu transfertën në kohën e blerjes së këtij apartamenti).

4.11. Për sa më sipër, referuar transaksioneve, nuk provohet bindshëm mundësia financiare e babait të subjektit për dhënien hua prej 39,000 euro, znj. N.T. në datën 28.8.2014.

4.12. Nga faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit që provojnë ekzistencën e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me apartamentin, për shkak të dhënies së huas prej tij në vlerën 500,000 lekë, deklaruar në vitin 2014, dhe dhënies së huas prej babait në vlerën 39,000 euro, pjesë e së cilës kanë qenë dhe vlera monetare depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, në llogarinë e babait; subjekti i rivlerësimit duhet t’i provonte trupit gjykues

burimet e ligjshme financiare të vjehrrës për blerjen e këtij apartamenti dhe burimet e ligjshme financiare të babait të tij, për dhënien hua prej 39,000 euro për blerjen e këtij apartamenti.

5. Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional

5.1. Komisioni administroi dosjet e procedimit penal nr. ****, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; procedimit penal nr. ****, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë; dhe kallëzimit penal nr. *****, nga prokuroria panë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

5.2. Nga dosja e procedimit penal nr. ****, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë prezentë rrethanën rënduese të të akuzuarit, i cili rezultoi të ishte recidiv/përsëritës, për të njëjtën vepër penale.

5.3. Nga dosja e procedimit penal nr. ***, u konstatua se hetimi nuk ishte kryer i plotë nga subjekti i rivlerësimit, nuk ishin mbledhur provat për qartësimin e rrethanave të akuzës së ngritur, të lëna si detyrë nga gjykata.

5.4. Nga dosja e procedimit penal nr. ****, u konstatua se subjekti nuk kishte kryer veprime hetimore të plota, që do mundësonin marrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar.

5.5. Në përfundim në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, kam vlerësuar se:

- subjekti i rivlerësimit, duke mos arsyetuar mbi rrethanat rënduese (proc.penal nr. ****), ka mangësi në njohuritë ligjore, në përputhje me pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

- subjekti i rivlerësimit, të paktën në dy raste (proc. penal nr. **** dhe nr. ****), nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave, në përputhje me pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

5.6. Situatat ligjore dhe faktike më sipër, referuar jurisprudencës së Kolegjit, janë të mjaftueshme për t'u vlerësuar dhe për të konkluduar mbi vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2, të së njëjtit ligj, si dhe sipas nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

5.7. Bazuar në përfundimet e mësipërme dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa "b" dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kuptim të nenit 61, pikat 5, 4 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, prandaj duhej zbatuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, mbështetur në pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE

Anëtare/në pakicë